



Nr. 44 Viti i pestë i botimit Janar 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Inkurajim për ruajtjen e natyrës ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi
- CO-SEED, Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm
- Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve të egra në Shqipëri
- Letër interesi për krijimin e grupimit "Të shpëtojmë arinjtë Shqiptarë"
- Njoftime



Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri i uron Gëzuar Festat e fund vitit të gjithë lexuesve, miqve, kolegëve, bashkëpunëtorëve dhe dashamirësve duke i falenderuar për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e frytshëm në fushën e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit në vendin tonë.

Ne kemi bindjen që Viti i Ri 2017 do të sjellë më shumë bashkëpunime, angazhime e përpjekje në realizimin e qëllimit tonë të përbashkët, ruajtjen e natyrës shqiptare dhe krijimi i një mjedisi sa më të qëndrueshëm për sot dhe brezat që do të vijnë.

Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



## ... me këtë rast Ju kujtojmë se 21 vjet më parë ...

Me VKM Nr. 102, datë 15.01.1996 "Për miratimin në parim të strategjisë për zbatimin e projektit për vlerësimin mjedisor nga zbatimi i projektit të pyjeve (aneksi Rrjeti i Zonave të Mbrojtura)", pas studimit ekologjik të pyjeve të virgjër të Shqipërisë, u miratuan:

### 1. Rezervat Strikt Natyror

1. Lumi i Gashit, me sipërfaqe 3,000.0 ha, qarku Kukës, rrethi Tropojë.

2. Kardhiqi, me sipërfaqe 1,800.0 ha, qarku Gjirokastrë, rrethi Gjirokastrë.

3. Laguna e Karavastasë, me sipërfaqe 5,000.0 ha, qarku Fier, rrethi Lushnjë, më pas u përfshi në sipërfaqen e zgjeruar të PK "Divjakë-Karavasta".

4. Rrajca, me sipërfaqe 4,700.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd, më pas u përfshi në sipërfaqen e PK "Shebenik-Jabllanicë".

### 2. Park Kombëtar

1. Lugina e Valbonës, me sipërfaqe 8,000.0 ha, qarku Kukës, rrethi Tropojë.

2. Mali i Tomorrit, me sipërfaqe 4,000.0 ha, qarku Berat, rrethi Berat, më pas u përfshi në sipërfaqen e PK "Mali i Tomorrit".

3. Bredhi i Hotovës, me sipërfaqe 1,200.0 ha, qarku Gjirokastrë, rrethi Përmet, më pas u përfshi në sipërfaqen e PK "Bredhi i Hotovës-Dangëlli".

4. Qafë Shtama, me sipërfaqe 2,000.0 ha, qarku Durrës, rrethi Krujë.

5. Zall Gjocaj 140 ha

### 3. Monument Natyre

1. Bredhi i Sotirës, me sipërfaqe 1,740.0 ha, qarku Gjirokastrë, rrethi Gjirokastrë.

2. Zhej, me sipërfaqe 1,500.0 ha, qarku Gjirokastrë, rrethi Gjirokastrë.

3. Syri i Kaltër, me sipërfaqe 180.0 ha, qarku Vlorë, rrethi Delvinë.

4. Vlashaj, me sipërfaqe 50.0 ha, qarku Dibër, rrethi Peshkopi.

### 4. Rezervat Natyror i Menaxhuar

1. Rrëzoma, me sipërfaqe 1,490.0 ha, qarku Vlorë, rrethi Delvinë.

2. Tej Drini i Bardhë, me sipërfaqe 30.0 ha, qarku Kukës, rrethi Has.

3. Gërmenj-Shelegur, me sipërfaqe 430.0 ha, qarku Korçë, rrethi Kolonjë.

4. Polis, me sipërfaqe 45.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

5. Stravaj, me sipërfaqe 400.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

6. S opot, me sipërfaqe 300.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

7. Dardhë-Xhyrë, me sipërfaqe 400.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

8. Qarrishtë, me sipërfaqe 318 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

### 5. Peizazhi Mbrojtur

1. Nikolicë, me sipërfaqe 510.0 ha, qarku Korçë, rrethi Devoll.

2. Bizë, me sipërfaqe 1370 ha, qarku Tiranë, rrethi Tiranë, më pas përfshihet në PM "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh".

3. Berdheti, me sipërfaqe 670 ha, qarku Tiranë, rrethi Tiranë, më pas përfshihet në PM "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh".

### 6. Zonë e Mbrojtur e Burimeve Natyrore të Menaxhuara

1. Luzni-Bulaç, me sipërfaqe 5,900.0 ha, qarku Dibër, rrethi Peshkopi e Bulqizë.

2. Piska-Shqeri, me sipërfaqe 5,400.0 ha, qarku Korçë, rrethi Kolonjë.

3. Bjeshka e Oroshit, me sipërfaqe 4,745.0 ha, qarku Lezhë, rrethi Mirditë.

4. Guri i Nikës, me sipërfaqe 2,000.0 ha, qarku Korçë, rrethi Pogradec.

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA është e gatshme që të ndihmojë për promovimin e vlerave të natyrës e të biodiversitetit, në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e historisë së zonave të mbrojtura të Shqipërisë.



## Inkurajim për ruajtjen e natyrës ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi

Podgoricë, Mal i Zi, 05 Dhjetor 2016 - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura e Shqipërisë dhe Ndërmarrja Publike e Parqeve Kombëtare në Malin të Zi, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, duke vendosur së bashku që të rrisin bashkëpunimin ndërkufitar për mbrojtjen e natyrës. Vetëm përdorimi i mençur e biodiversitetit do të garantojë ruajtjen e burimeve natyrore për të mirën e njerëzve në të dyja vendet.

Ky aktivitet u zhvillua gjatë Konferencës përmbylëse në Mal të Zi të projektit



Në Konferencë morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm e AKZM z.Zamir Dedej, Drejtoresha e Ndërmarrjes Publike të Parqeve Kombëtare në Malin të Zi znj. Azra Vukovic, Drejtori i Zyrës Rajonale të IUCN për Europën Lindore dhe Azinë Qendrore z.Boris Erg, Presidenti i INCA z.Genti Kromidha, Drejtoresha e Green Home në Malin e Zi znj. Nataša Kovačević, specialistë të fushës, përfaqësues të botës akademike, të OJF-ve, medias etj



"Mbështetje për menaxhimin e qëndrueshëm e afatgjatë të Liqenit ndërkufitar të Shkodrës" i cili ishte një projekt 3 vjeçar i IUCN dhe synonte të nxisë menaxhimin efektiv të biodiversitetit të liqenit të Shkodrës nëpërmjet përmirësimit të praktikave dhe kapaciteteve për menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ky projekt u zbatua nga INCA në Shqipëri dhe Green Home në Mal të Zi.





## CO-SEED / Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social Ekonomik mbi Bazat e një Mjedis të Shëndetshëm

Tiranë, 8-9 Dhjetor 2016 - Në kuadër të projektit CO-SEED - “Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social Ekonomik mbi Bazat e një Mjedis të Shëndetshëm”, u organizua në ambientet e Hotel Xheko Imperial në Tiranë, trajnimi rajonal për pjesëmarrje në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe në procesin e vlerësimit strategjik mjedisor.

Në trajnim morën pjesë OJF të ndryshme nga Shqipëria, Turqia, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnie & Hercegovina.

Projekti CO-SEED po zbatohet në vendet:



Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Serbi dhe Turqi. Partneri kryesor që drejton zbatimin e projektit (koordinatori) është WWF Turqi. Partnerët e projektit janë: INCA-Shqipëri, Udruga Dinarica-Bosnia dhe Hercegovina, WWF Adria-Kroaci, Zeleni Dom - Green Home-Mali i Zi dhe Shoqata e Studimeve Shoqërore dhe Mbrojtjes së Shpendëve-Serbi.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian përmes programit të lehtësimit të Shoqërisë Civile dhe mediave të Bashkimit Evropian 2014-2015 - Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.

## Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve të egra në Shqipëri

Tiranë, 16 Dhjetor 2016 - Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), në kuadër të projektit “Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMSHC) Shqiptare për promovimin e mbrojtjes së natyrës në Shqipëri”, mbështetur prej programit ACHIEVE, organizoi tavolinën e rrumbullakët me temë “Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve të egra në Shqipëri”.

Në takim morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, të AKZM, të REC Shqipëri, të ISHMP, të organizatës “Katër Putrat” dhe përfaqësues të shoqërisë civile shqiptare, të kosovës dhe asaj italiane.

Fokusi i kësaj tavoline ishte diskutimi mbi problematikën e mbajtjes në gjendje robërie të arinjëve dhe të individëve të kafshëve të egra që përdoren për koleksione, balsamime, etj, pasi gjendja paraqitet tepër shqetësuese.

Vihet re shtimi i përpjekjeve nga MM e cila ka forcuar kontrollin, zbatimin e ligjshmërisë si dhe

mundësinë e koordinimit dhe të bashkërendimit të përpjekjeve të përbashkëta për përmirësimin e gjendjes, pas sinjalizimeve dhe evidentimit të rasteve të gjendjes së rënduar të keqtrajtimit të kafshëve të egra.

INCA, mbështetur nga programi ACHIEVE, ka nisur përpjekjet për vlerësimin kombëtar dhe

*Vijon në faqe 5*





*Vijon nga faqe 4* monitorimin e gjëndjes ekzistuese të kopshteve zoo-ve dhe të trajtimit të kafshëve të egra në to, ndërkohe që organizata të tjera janë duke vazhduar përpjekjet për përmirësimin e situatës së arinjve në gjëndje robërie.



Gjatë kësaj tavoline, përveç të tjerash, u diskutua mbi fillimin i procesit të vlerësimit të gjëndjes, të inventarizimit, të vendosjes së mikroçipave të arinjve dhe gjithashtu të matrikullimit të individëve të llojeve të faunës së egër që përdoren për koleksione, trofe, balsamim, në lokale tregtie, shërbimi e argëtimi apo dhe ekspozim të pjesëve të tyre si të

lëkurëve, brirëve, dhëmbëve, puplave, etj, duke siguruar matrikullat përkatëse, kjo në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9867, datë 31.01.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar.

Në këtë takim, krahas dhënies së udhëzimeve për nisjen e procesit të inventarizimit dhe matrikullimit të kafshëve të egra, u prezantua nisma e re për krijimin e grupimit “Bears Albania”, i cili synon vendosjen e hapave konkrete të bashkëpunimit me të gjithë aktorët për shpëtimin e kafshëve të egra në gjëndje robërie apo dhe të përdorimeve të tjera të jashtëligjshme



### *Letër interesi për krijimin e grupimit "Të shpëtojmë arinjtë Shqiptarë"*

Në mbështetje të angazhimit të Ministrisë së Mjedisit, për t'i dhënë fund robërisë mizore e ariut të murrmë (*Ursus arctos*) në Shqipëri, një grupim organizatash dhe institucionesh, që janë të angazhuar në ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit, i përbërë nga:

1. Ministria e Mjedisit të Shqipërisë (MM),
2. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA),
3. Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura në Shqipëri (NAPA)
4. Animal Rescue Albania (ARA),
5. Shoqata Shqiptare për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e shpendëve dhe gjitarëve (ASPBM)
6. VIER PFOTEN (FOUR PAWS) International
7. Associazione Salviamo Gli Orsi della Luna (Asol)
8. etj...

formohet për të punuar bashkërisht, për një zgjidhje të qëndrueshme për arinjtë shqiptarë në gjëndje robërie.

Grupimi ndjek politikën e dyerve të hapura dhe mirëpret aktorë të tjerë të interesuar për tju bashkuar kësaj iniciative.

Qëllimi kryesor i këtij grupimit është t'i jepet fund mbajtjes mizore të arinjve në Shqipëri dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në mbrojtjen dhe mbijetesën e ariut të murrmë në Shqipëri.

Për të përmbushur këtë objektiv, anëtarët bien dakord për një strategji të qartë si dhe marrjen e masave specifike për t'i dhënë fund robërisë mizore të arinjve dhe uljen e kërkesës për arinj të lindur në gjëndje të egër, në nivele të papërfillshme.

Strategjia bazohet në katër linja kryesore veprimi (në mbështetje të punës së Ministrisë së Mjedisit):

- Ngritjen e një grupimi/rrjeti të përbashkët për të koordinuar shpëtimin e ariut (përfshirë krijimin e një baze të përbashkët të dhënash të arinjve të mbajtur në robëri, dhënien përparësi shpëtimin të individëve dhe

*Vijon në faqe 6*

Vijon nga faqe 5 organizimin e përbashkët për instalimit të pajisjeve të shpëtimit);

- Mbështetjen e zbatimit të rreptë të ligjeve ekzistuese dhe advokimin për një ligj të ri, i cili ndalon mbajtjen private të arinjve dhe gjithashtu sigurimin e zbatimit siç duhet të tij;

- Krijimin e ndërgjegjësimit për ruajtjen dhe mirëqenien kafshëve të egra;

- Mbështetjen dhe konsultimin e ndërtimit të një qendre për mbajtjen dhe shpëtimin e arinjve në Shqipëri, e cila vepron si një bazë për zgjidhjen e qëndrueshme e afat të gjatë për arinjtë në gjendje robërie.

Në lidhje me objektivat dhe strategjitë e përmendura më sipër, palët e këtij koalicioni bien dakord mbi këto detyrime dhe parime bashkëpunimi:

- shkëmbimin e informacionit mbi gjendjen e mbajtjes së arinjve në gjendje robërie në Shqipëri;

- shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet e planifikuara, të cilat kanë të bëjnë me mbajtjen e arinjve në gjendje robërie;

- Veprime të përbashkëta shpëtimi (nëse është e mundur) dhe aktivitete tjera që synojnë arritjen e objektivave të lartpërmendura;

- Takime të rregullta (të paktën një herë në çdo 2 muaj) me qëllim përditësimin e palëve mbi veprimet e sipërpërmendura, progresin e ndryshimeve ligjore dhe zbatimit të tij, por në rast se është e nevojshme takimet mund të

organizohen edhe më shpesh.

Në këtë mënyrë, palët bien dakord që Ministria e Mjedisit, përmes Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (NAPA), të veprojë si mbikëqyrëse e koalicionit. Koordinator i projektit FOUR PAWS (Katër putrat) në Shqipëri të veprojë si koordinator dhe zëdhënës i koalicionit.

Tiranë, më .....

- PËR DHE NË EMËR TË

Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (Ministria e Mjedisit)

- PËR DHE NË EMËR TË

Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri

- PËR DHE NË EMËR TË

Animal Rescue Albania

- PËR DHE NË EMËR TË

Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

- PËR DHE NË EMËR TË

VIER PFOTEN (FOUR PAWS) International

- PËR DHE NË EMËR TË

Shoqatës Shqiptare për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e shpendëve dhe gjitarëve

- PËR DHE NË EMËR TË

Associazione Salviamo gli Orsi della Luna

## NJOFTIME

### 27 Janar - Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

1 - Congress on ecological status and valuation of European lowland lakes - from 8 to 10th February 2017 at La Maison du Lac de Grand-Lieu at Bouaye (France). For more detailed information please visit the congress webpage: [www.maisondulacdegrandlieu.com/european-congress](http://www.maisondulacdegrandlieu.com/european-congress)

2 - Për të lexuar “Ditari i Natyrës” në vite... / <http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

## Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA  
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437  
[www.inca-al.org](http://www.inca-al.org); [info@inca-al.org](mailto:info@inca-al.org); [www.facebook.com/inca.albania](https://www.facebook.com/inca.albania)